REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA SARANDË
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i barazisë gjinore dhe mirëqënies sociale

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projektvendimit nr.49,datë 30.04.2025, relacionit e dokumentet shoqëruese në lidhje me propozimin për "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I STREHIMIT "BANESAVE ME KOSTO TË ULËT SUBVENSIONIMIT TË INTERESAVE TË KREDISË ME KUSHTE LEHTËSUESE NGA SHTETI PËR VITIN 2025".

Analiza ligjore:

Në mbështetje të nenit 113 pika 2 të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja b dhe nënpika 1.2, shkronja c, nenit 54, shkronja e/1, nenit 55, pikat 3 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, Mbështetur në Ligjin Nr 22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar Ligji Nr. 48/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 22/2018", neni 8 pika 2 dhe neni 9 pika 1.1 b dhe neni 24 pika 2 , si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim , sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore" dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 453 datë 03.07.2019 " Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe proceduren e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti", i ndryshuar me VKM Nr. 268 datë 29.04.2022, Vendim të Komisionit të Strehimit nr.2 datë 16.04.2025.

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)
Duke qenë se afati për aplikim të përfituesve për subvencionim të interesave të kredisë me kushte lehtësuese nga shteti nga listat e mëparshme ka përfunduar, Drejtoria e Kujdesit Social është informuar nga Enti Kombëtar i Banesave lidhur me numrin e aplikantëve që iu eshte disbursuar kredia (91) dhe numrin e aplikanteve të cilët kanë bërë kërkesë për shtyrje të afatit të kredisë me 6 muaj (10). Nga kjo analizë rezulton se ka kuota të lira dhe për këtë arsye është bërë shqyrtimi i kërkesave të reja për këtë program strehimi.

Fillimisht është bërë shqyrtimi i dokumentacionit për secilin aplikant. Në vijimësi u hartua lista dhe në bazë të sistemit të miratuar të pikëzimit me Vendim Këshilli Bashkiak Nr. 57 datë 30.09.2024, u bë renditja e aplikantëve. Duke patur parasysh pikët për çdo familje sipas gjendjes

social-ekonomike të tyre komisioni i strehimit i mbledhur në datë 16.04.2025 vendosi të skualifikojë aplikantët Z.N, Z.C, M.XH dhe A.B për arsye se të ardhurat neto të familjes së tyre i tejkalojnë të ardhurat mesatare që duhet të ketë një familje sipas tabelës të publikuar nga INSTAT dhe të miratuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtoria e Strehimit me shkresë nr. 12836/2prot. datë 13.11.2024, administruar pranë Bashkisë Sarandë me Nr. 6468 prot. datë 15.11.2024, si dhe në bazë të VKM Nr. 453 datë 03.07.2019 " Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe proceduren e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti", i ndryshuar me VKM Nr. 268 datë 29.04.2022.

Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)
Nuk ndryshon situata financiare.

Drejtoria / Sektori përgjegjës A

Drejtoria e Kujdesit Social, Bashkia Sarandë.

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Kujdesit Social, në Bashkinë Sarandë raporton disa herë në vit, sipas problematikës.

Impakti social / grupet që preken:

Familjet në kushte të vështira jetësore dhe pamundësi ekonomike.

Komisioni i Përhershëm, i mbledhur më datën 28.04.2025, shqyrtoi projektvendimin nr.49,datë 30.04.2025, relacionin e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I STREHIMIT "BANESAVE ME KOSTO TË ULËT SUBVENSIONIMIT TË INTERESAVE TË KREDISË ME KUSHTE LEHTËSUESE NGA SHTETI PËR VITIN 2025", paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.
Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:
   Miratimin e projektaktit

Laureta Çeçi **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Anjeza Dike **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Enea Vasili **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Datë 28.04.2025